



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 24.3.2023

Nr: 205

Ora: 12:00

VENDIM

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR 30, DATË 21.3.2023, TË KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE, PËR REGJISTRIMIN E PARTISË "LËVIZJA PËR ZHVILLIM KOMBËTAR" SI SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë, 24.3.2023 në seancë publike, pasi u njoha me vendimin nr.30, datë 21.3.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve,

V Ë R E J:

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve me shumicë votash ka vendosur:

1. Pranimin e kërkesës ankimore nr.35, datë 17.03.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor "Lëvizja për Zhvillim Kombëtar";
2. Ndryshimin e vendimit nr. 173, datë 14.03.2023 " Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike "Lëvizja për Zhvillim Kombëtar", për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
3. Detyrimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të regjistrojë partinë politike "Aleanca Progresiste LZHK", me Kryetar z. Dashamir Shehi, me shkronjat nistore "L.ZH.K", si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "n", dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe vendimit nr.30, datë 21.3.2023, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

Data: 24.3.2023 Nr: 205
Ora: 12:00



Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike "Lëvizja për Zhvillim Kombëtar", për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

V E N D O S:

1. Regjistrimin e partisë politike “Aleanca Progresiste L.ZH.K”, me shkronja nistore “L.ZH.K”, me kryetar, z. Dashamir Shehi, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

